



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr. 79, datë 16.02.2023

PËR

**DETAJIMIN E FONDIT TË VEÇANTË PËR SISTEMIN GJYQËSOR, PËR VITIN
2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e detajimit të fondit të veçantë, për sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2023, në vlerën prej 4 500 000 lekë, përkatësisht sipas programeve buxhetore:
 - për programin 01110 – në vlerën 1 200 000 lekë,
 - për programin 01140 – në vlerën 100 000 lekë,
 - për programin 03310 - në vlerën 3 200 000 lekë.
2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR